



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 186 / Prot.
13

Tiranë, më 08 / 4 / 2016

REKOMANDIM

Nr. 07 datë 08 / 4 / 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në ngarkim të klinikës-kontrolluesit, "Medicare" me formë ligjore të aktivitetit person juridik, NIPT: K31410075F.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr.28, datë 16.02.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 22.02.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procedurën e hetimit administrativ, pranë kontrolluesit klinika "Medicare" sh.p.k., me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit, klinika "Medicare" sh.p.k., i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Kontrolluesi klinika "Medicare" sh.p.k., ka një aktivitet të kufizuar në raport me klinikat apo laboratorët e tjera, pasi është një klinikë që kryen vetëm aktivitet mjekësor imazherie. Ky fakt nuk e përjashton këtë kontrollues nga detyrimet që burojnë prej Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, pasi dhe imazheria është një formë e mbledhjes së të dhënave personale të subjekteve-pacientë. Në raport me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat që grumbullohen ky kontrollues nuk janë të një game të gjerë.

1. Kontrolluesi klinika "Medicare" sh.p.k., e ka përmbushur detyrimin e njoftimit, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por nuk përditëson të dhënat që pëson aktiviteti i tij në vite, sidomos deklarinimin e subjekteve apo institucioneve drejt të cilave përhapen të dhënat personale në palë të treta, dhe konkretisht:
 - a) Nuk është përditësuar në rubrikën 7.1., marrësi i të dhënave, shoqëria private e sigurisë fizike "Rogat Security Group" sh.p.k, e cila ka akses në regjistrimet nga

sistemi i kamerave vëzhguese CCTV, dhe me të cilën ka lidhur kontratën në datë 01.01.2016.

b) Nuk është përditësuar fakti, sipas rubrikës 10.1., që kontrolluesi ka një rregullore të brendshme që flet për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Kontrolluesi, nuk ka rregullore të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, ku të saktësohen dhe përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e kontrolluesit dhe detyrimisht, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, por është i çertifikuar nga qendra e akreditimit të cilësisë. (Zyra italiane e akreditimeve) sipas ISO 9001:2008.

3. Kontrolluesi, në marrëdhëniet kontraktuale me të tretët- përpunuesit, ka të parashikuar, rregullat e konfidencialitetit me palën tjetër, por në funksion të mbrojtjes së të dhënave të subjekteve-pacientë, mbetet i paqartë.

Në datën 05.04.2016, nga Zyra e Komisionerit është realizuar seanca dëgjimore mbi ezaurimin e së drejtës të palëve për tu dëgjuar, konform nenit 93 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar, ku kontrolluesi “Medicare” sh.p.k., shprehu gatishmërinë për të rikuperuar gjetjet e konstatuara nga grupi i inspektimit në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson faktin që, kontrolluesi “Medicare” sh.p.k., gjatë kontrollit nga grupi i hetimit administrativ ka qënë bashkëpunues. dhe reagues në lidhje me zbatimin e Ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura në sektorin e shëndetësisë.

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Medicare” sh.p.k., të përditësojë rubrikat si më lart cituar, duke sjellë në vëmendje të tij, së përditësimi është një proces në vazhdimësi dhe si tillë të mos neglizhohet.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip, në rastet e këtij delegimi”, kontrolluesi “Medicare” sh.p.k., të hartojë aneks kontratat sipas standarteve të shprehura në aktet e dala nga Komisioneri në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve – pacientë.
3. Kontrolluesi, detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit, duhet ta realizojë brenda një afati kohor, prej 30 ditësh.

1. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 08. 4 .2016

